

Elbasa, më 02/02/2022

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TËKUFIZUAR**

**“IGS Resources “ sh.p.k.**

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Selia**

**Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe themeluesit**

Sot, më datë 02.02.2022, është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “IGS Resources “ sh.p.k. ka selinë e saj në: Zona Kadastarale Nr.3965 Nr.Pasurise 832/1 Elbasan Metalurgji

Themelues dhe ortak i shoqërisë është:

“IGS Resources” sh.p.k LUFTAR KASA, i biri i Rizait , i lindur në datë 21/09/1972 në Sinametaj , Peqin me shtetësi Shqiptare, e identifikuar me pasaporten nr BB7740396.

**Neni 2:Objekti**

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

Prodhimi I Tubave prej PE , PP , PVC, MDPE dhe LDPE te llojeve dhe diametrave te ndryshem ,presioneve te ndryshme .

Import Eksport I te gjithave lendeve te para per prodhimin e tubave Plastike per uje te Pijshem , Kanalizimet te ujrave te zeza dhe ujrave te shiut , drenazhime dhe vadiqe dhe gjithashtu tregtimi dhe shtitja e tyre me shumice dhe pakice , Impor -Eksport i te gjitha rakorderive plastike dhe hekuri , bakeri ,brozi etj, per kompletimin e projekteve te ujsjellesave dhe kanalizimeve .

Projektim dhe zbatim te projektve te ndryshme te ndertimit te ujesjellsave dhe kanalizimeve , Dhenie Ekspertize ne projekte te ndryshme te ujesjellave dhe kanalizimeve etj .

**Për realizimin e qëllimit të mësipërm shoqëria ka të drejtë:**



- t'ju besojë të tretëve pjesë të punimeve të produkteve të saj ose shërbimeve;
- të përfundojë kontrata agjensie me ose pa përfaqësim, me qëllim që të promovojë për llogari të palës tjetër ose të promovohet nga pala tjetër për llogari të saj, aktivitetet dhe prodhimet e mësipërme, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e ndërmjetësimit të çfarëdo fushe;
- të operojë si në territorin kombëtar dhe jashtë tij.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet industriale, tregtare, mobiliare, imobiliare dhe financiare që do të konsiderohen nga ortakët apo nga organi Administrativ të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet e ndërmjetësimit industrial, tregtar, mobiliar, imobiliar dhe financiar që do të konsiderohen të nevojshme dhe/ose të dobishme nga ortakët për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar. Shoqëria mund të blejë lirisht kuota apo aksione të shoqërive të tjera, vendase dhe të huaja.

### Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin nëfuqi. Ky afat mund tëkufizohet me vendim asambleje.

### Neni 4: Selia

-Shoqëria ka selinë ligjore në adresën ne: Zona Kadastarale Nr.3965 Nr.Pasurise 832/1 Elbasan Metalurgji

-Transferimi i selisë brenda të njëjtës Bashki, apo dhe në Bashki të tjetër, mund të vendoset nga organi administrativ dhe nuk do të sjellë modifikimin e statutit.

## Kreu II

### Kapitali themeltar

#### Neni 5: Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 ( njëqind ) lekë dhe është i ndarë në kuota në kuptim të Ligjit. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në masën 1 kuote secili.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni 6) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

##### 6.1 Zmadhimi i kapitalit

- Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë ose kredi.
- Administratorit nuk i jepet e drejta të zmadhojë kapitalin, e drejtë kjo që disponohet vetëm nga ortakët.

#### 6.2 Zvogëlimi i kapitalit.

- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Administratorit nuk i jepet e drejta të zvogëlojë kapitalin, si dhe të kryejë veprime bankare pa një autorizim të asamblesë së ortakëve, i cili do të jepet me Vendim Asambleje, në format e kërkuara nga ligjit.

#### Neni 7) Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### Kreu III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

##### Neni 8: Organi vendimmarrës

8.1 - Ortaku i Shoqërisë është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Ortaku mund të marre vendime pranë selisë së shoqërisë ose në tjetër vend, me kusht që ky të ndodhet brenda territorit Shqiptar.

Ortaku është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- 1) ndryshimet e statutit;
- 2) emërimin e shkarkimin e administratorit/administratorëve;
- 3) autorizimin e administratorit për kryerjen e veprimeve me bankat, autorizim i cili do të jepet rast pas rasti për kryerjen e veprimeve të caktuara;
- 4) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 5) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat "3" dhe "4" të pikës 8.1 të këtij neni;
- 6) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetor dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- 7) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - 8) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - 9) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - 10) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - 11) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - 12) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - 13) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut.

#### Neni 9: Marrja e vendimeve

Ortaku vendos për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Ortaku vendos për çështje të tjera si:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
3. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
4. përcaktimin e shpërblimeve;
5. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
7. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### Neni 10: Administrimi

Ortaku emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas parashikimeve të nenit 207 të Ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë.

**LUFTAR KASA, i biri i Rizait , i lindur në datë 21/09/1972 në Sinametaj , Peqin me shtetësi Shqiptare, e identifikuar me pasaporten nr. BB7740396.**  
i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga ortaku.

Pushimi administratorit për arsye të mbarimit të afatit të emërimit, ka efekt nga momenti në të cilin emërohet organi i administrimit pasues.

#### **Neni 11: Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- 1) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- 2) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- 3) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 4) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve për miratim;
- 5) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 6) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- 7) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- 8) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut.

Administratorët janë të detyruar të kerkojnë Vendim nga Ortaku kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, kuota të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Nëse Ortaku emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë, alternativisht, me përjashtim të rasteve kur asambleja e ortakëve merr vendim ndryshe.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori nuk do të ketë tagra të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo persona të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim nga Ortaku.

Ortaku mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë më shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të



marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 12: Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që sjellin dëm për shoqërinë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit, pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. A) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.

B) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

C) të vlerësojë më përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;

D) të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm të interesave personalë me ata të shoqërisë;

E) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:

a) I kthen ortakeve kontributet;

b) I paguan ortakeve interesa apo dividendë;

c) I shpërndan aktivet shoqërisë;

d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësi kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë përfshirë dhe dëmshpërblimin financiar nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblese se Ortakeve nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti financiar**

##### **Neni 13: Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përrjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

#### **Kreu V** **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 14: Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të Asamblese se Ortakeve.
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) Me vendim të gjykatës;
- f) Në këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Nëse ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund të drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

##### **Neni 15: Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblese se Ortakeve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

##### **Neni 16: Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet me këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 17: Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare dhe më konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

#### **Neni 18: Klauzola të kompromisit**


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakut dhe shoqërisë, në lidhje me raportet shoqërore ose për interpretimin dhe zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërish të nxjerra nga organet e shoqërisë, ato të emëruara nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do të paraqiten Gjykatës në Rrethin në të cilin shoqëria ka selinë.

#### **Neni 19: Referimet**


Për sa nuk është shprehimisht përcaktuar në këtë statut, vlejnjë dispozitat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe të ligjeve apo akteve nënligjore të posaçme të fushës.

### **ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "IGS Resources" shpk**

**Z.LUFTAR KASA**



**ADMINISTRATORI  
Z.LUFTAR KASA**



Elbasan, më 02.02.2022